



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.141

24 tetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.655, datë 29.9.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit”, të ndryshuar	3903
Vendim i KM nr.658, datë 10.10.2007	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2007-2008	3905
Vendim i KM nr.659, datë 3.10.2007	Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike	3912
Vendim i KM nr.660, datë 12.9.2007	Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njëjësive të qeverisjes vendore	3917

VENDIM
Nr.655, datë 29.9.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.1.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit janë sipas lidhjes nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”.

2. Lidhja nr.3, që përmendet në pikën 6, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtën numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paragrafi i dytë, i pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

““Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët” në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë” përfitojnë një shtesë, për “kushte pune”, 10 000 (dhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore, të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicionit të punës. Përfshihen nga ky parashikim nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare:

- nga data 1 korrik 2007, për efekt të ndryshimit të lidhjes nr.3;

- nga data e emërimit të nëpunësve, për përcaktimet që lidhen me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË AGJENCINË KOMBËTARE TË
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3	4	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit.	II-a	10.050	2%		100.500	20.000
Drejtor drejtorie, në drejtorinë e përmbajtjes.	II-b	10.050	2%		84.000	15.000
Drejtor drejtorie, në drejtoritë mbështetëse.	II-b	10.050	2%		84.000	0
Përgjegjës sektori, në sektorët e përmbajtjes.	III-a/1	10.050	2%		55.000	20.000
Përgjegjës sektori, në sektorët mbështetës.	III-a/1	10.050	2%		55.000	0
	III-b	10.050	2%		49.000	0
Specialist, në sektorët, apo drejtoritë e përmbajtjes.	III-b	10.050	2%		49.000	25.000
Specialist, në sektorët, apo drejtoritë mbështetëse.	IV-a	10.050	2%		37.450	0
	IV-b	10.050	2%		25.850	0

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
Titullar i institucionit.	Profesor.	30.000
	Profesor i asociuar.	25.000
Zv/titullar i institucionit, drejtor/drejtorie në institucion.	Doktor i Shkencave.	20.000
	Doktor i Shkencave (doktoraturë e mbrojtur në vendet perëndimore).	25.000
Përgjegjës sektori; anëtar i organit drejtues; specialist.	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë. Studime specializuese afatgjata.	10.000
	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë (diplomuar në vendet perëndimore).	20.000

VENDIM
Nr.658, datë 10.10.2007

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE, NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2007-2008

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit dhe studentët, që vazhdojnë studimet me shkëputje nga puna, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, të cilat përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Përfitojnë bursë, brenda kuotave të përcaktuara në këtë vendim:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) Nxënësit/studentët, që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre, në largësinë mbi 5 km dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit, që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km e që vendosen në konvikt publik.

c) Nxënësit/studentët që kanë përfituar statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

ç) Nxënësit/studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjyqate të formës së prerë dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

d) Secili nga studentët bashkëshort, me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik e që vendoset në konvikt publik.

dh) Fëmija, nxënës apo student, i punonjësit të policisë, që ka humbur jetën në krye a për shkak të detyrës.

e) Fëmija, nxënës apo student, që ka statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, dhe që plotëson kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë):

a) Nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10-ta.

b) Studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që kanë mbaruar shkollën e mesme me Medalje Ari.

c) Studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që janë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës më të mirët e maturës shtetërore. Për vitin 2007 janë, gjithsej, 25 (njëzet e pesë).

ç) Studentët, që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10-ta.

d) Studentët që vazhdojnë studimet në degët matematikë dhe fizikë, për vitet e dyta e lart dhe që e kanë përfunduar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8.

3. Nxënësit/studentët nuk e përfitojnë ose/edhe e humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

3.1 janë ndarë nga trangu familjar;

3.2 familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

3.3 vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

3.4 humbasin vitin shkollor, për rezultate jokalue.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, për vitet e para, sipas kuotave të miratuara në nivel rrethi (për nxënës/studentë).

4.1 Drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA) pas këshillimeve me strukturat e pushtetit vendor, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave në bashki dhe komuna, në përshtatje me kërkesat e paraqitura, paraprakisht, prej tyre, për kategoritë e përcaktuara në pikën 2.1 të këtij vendimi.

4.2 Institucionet e arsimit të lartë paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kërkesat për studentët, që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes dhe ua dërgon për ekzekutim institucioneve të arsimit të lartë.

5. Bashkitë dhe komunat, së bashku me këshillat përkatëse, vendosin sipas planit të përcaktuar për to dhënien e bursave, të plotë apo gjysmëbursë, në respektim të kriterëve, ekonomike të përcaktuara në këtë vendim, duke u dhënë përparësi nxënësve/studentëve më në nevojë.

5.1 Bashkitë dhe komunat, detyrimisht, u dërgojnë në rrugë zyrtare drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.2 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, bashkive dhe komunave, që menaxhojnë konviktet, listën emërore të nxënësve/studentëve bursistë, së bashku me vendimet origjinale të këshillave bashkiake apo të komunave. Një kopje e listës emërore të nxënësve/studentëve bursistë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Bursat e nxënësve për vitet e dyta e lart rishqyrtohen, çdo vit, nga këshilli bashkiak apo i komunës, sipas vendndodhjes territoriale e administrative të konvikteve, ku janë vendosur nxënësit konviktorë.

Nxënësit, që në vitin e parë kanë përfitur bursë, me vendim të këshillit bashkiak apo të komunës, ku kanë vendbanimin, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike.

7. Bursat e studentëve për vitet e dyta e lart rishqyrtohen, çdo vit, nga institucionet e arsimit të lartë. Studentët e viteve të dyta e lart, që nuk kanë përfitur bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund ta përfitojnë atë brenda planit të bursave, të përcaktuar sipas këtij vendimi. Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët, që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2 është deri në 130 veta, në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave, të dhëna për vitin shkollor 2007-2008. Plani i shpërndarjes së tyre bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Studentët, që në vitin e parë kanë përfitur bursë me vendim të këshillit bashkiak apo të komunës, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike.

8. Bursa për studentin administrohet nga institucionet e arsimit të lartë dhe derdhet çdo muaj në llogarinë e tij bankare. Bursa për nxënësit administrohet nga bashkia/komuna, sipas vendndodhjes, territoriale dhe administrative, të konvikteve, ku është vendosur nxënësi konviktor dhe i jepet vetëm me ushqim, në konvikte.

9. Nga plani i bursave, të miratuar për vitin shkollor 2007-2008, Bashkisë së Tiranës i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) bursa të larta, për studentët, që vijnë nga familjet me të ardhura të pakta, për rastet

e invalidëve paraplegjikë, tetraplegjikë e të tjerë, duke i përjashtuar nga kriteri, që të vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit të tyre.

10. Nxënësit/studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve, që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve, që nuk Shikojnë, përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore etj., sipas pasqyrës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kjo kategori nxënësish/studentësh përjashtohet nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë shkollat.

Nxënësve/studentëve, që kanë përfituar statusin e jetimit, u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës dhe të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

Nxënësit jetimë e përfitojnë bursën edhe gjatë pushimeve verore, si dhe vetëm një vit, kur humbasin vitin shkollor, për rezultate jokaluese.

Fëmijët dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqim (drekë), me vlerë deri në 100 lekë në ditë.

11. Niveli i bursës për nxënësit dhe studentët është, përkatësisht, sipas pasqyrave nr.2 e nr.3, ndërsa kuota financiare ushqimore ditore është sipas pasqyrave nr.4 e nr.5, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

12. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin shkollor 2007-2008, i jepen 1600 bursa për arsimin e mesëm dhe 1600 bursa për arsimin e lartë, për të gjitha kategoritë e parashikuara në shkronjat “a” e “b” të pikës 2 të këtij vendimi.

13. Efektet financiare për vitin shkollor 2007-2008 të përballohen nga buxheti i shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për vitin 2007, për pjesën e vitit 2007, dhe nga buxheti, që do të miratohet për vitin 2008, për pjesën e vitit 2008.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para është data 15 dhjetor 2007, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitet e dyta e lart është data 15 nëntor 2007.

Në raste të veçanta, kur këshilli bashkiak apo i komunës nuk mund ta miratojë brenda këtij afati numrin e bursave të dhëna, mbetet kompetencë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës shqyrtimi i këtyre vendimeve, rast pas rasti.

15. Vendimi nr.737, datë 1.11.2006 i Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike”, shfuqizohet.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të gjitha njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS
(Viti mësimor 2007-2008)

Pasqyra nr.1

Të ardhurat mujore për frymë

Nr	Përbërja familjare	Bursa	Gjysëm bursa	Me pagesë
	Për qytetin			
1	Për familjet me 2 persona	Deri 2600 lekë	2600-3600 lekë	Mbi 3600 lekë
2	Për familjet me 3 persona	Deri 2500 lekë	2500-3500 lekë	Mbi 3500
3	Për familjet me 4 persona	Deri 2400 lekë	2400-3400 lekë	Mbi 3400
4	Për familjet me 5 persona	Deri 2300 lekë	2300-3300 lekë	Mbi 3300
5	Për familjet me 6 persona	Deri 2200 lekë	2200-3200 lekë	Mbi 3200
6	Për familjet me 7 persona	Deri 2100 lekë	2100-3100 lekë	Mbi 3100
7	Për familjet me 8 persona	Deri 2000 lekë	2000-3000 lekë	Mbi 3000

Shënim: Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë të plotë, kur familja përfiton ndihma ekonomike të plotë dhe 50% të bursës së plotë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme

NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT
(Viti mësimor 2006-2007)

PASQYRA NR 2
Në lekë

NR	Kategoritë nxënësve Sipas shkollave	Bursat dhe pagesat e nxënësit	Financimi nga shteti	Financimi nga nxënësit	Për ushqim	Shpenzi me vetjake
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	Bursa	5000	5000		4800	200
	Gjysëm bursa	5000	2500	2500	4800	200
	Me pagesë	5000		5000	4800	200
2	Shkolla e mjeshtresë sportive dhe nxënësit e arsimit special					
	Bursa	5500	5500		5300	200
	Gjysëm bursa	5500	2750	2750	5300	200
	Me pagesë	5500		5500	5300	200
3	Nxënësit jetim	5500	5500		5300	200

NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT
(Viti mësimor 2007-2008)

PASQYRA NR 3

Në lekë

NR	Kategoritë e studentëve sipas shkollave	Bursat dhe pagesat e studentëve	Financimi nga shteti	Financimi nga studenti	Kuota e ushqim	Kuota e fjetjes
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe Shkolla e Lartë e Infermierisë					
	Bursa	8000	8000		6500	1500
	Gjysëm bursa	8000	4000	4000	6500	1500
	Me pagesë	8000		8000	6500	1500
2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	Bursa	8500	8500		7000	1500
	Gjysëm bursa	8500	4250	4250	7000	1500
	Me pagesë	8500		8500	7000	1500

Kuotat financiare sipas normave në natyrë për ushqimin e nxënësve

(Viti mësimor 2007-2008)

PASQYRA NR 4

Nr	EMËRTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjitike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera
1	BUKË	Gram	400	1117	55	22
2	MAKARONA	"	30	107	80	2.4
3	ORIZ	"	30	109	70	2.1
4	SHEQER	"	40	157	60	2.4
5	FASULE	"	30	93	150	4.6
6	PERIME	"	130	27	70	9.2
7	FRUTA	"	100	42	100	10
8	VAJ	"	30	270	170	5.1
9	GJALP	"	20	152	500	10
10	MISH	"	90	130	550	49.5
11	DJATH	"	25	40	350	8.75
12	REÇEL	"	20	93	250	5
13	VEZË	kokërr	1	42	10	10
14	QUMËSHT	Gram	200	98	20	4
15	PATATE	"	200	170	50	10
16	Nënprodukte mishi	"	30	100	300	9
	KUOTA DITORE			2746		164

Shënim: Është e domosdoshme që nxënësi të marri kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menuve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorve të tjerë(gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

Kuotat financiare sipas normave në natyrë për ushqimin e studentëve (Viti mësimor 2007-2008)

PASQYRA NR 5

Nr	EMËRTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjitike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera
1	BUKË	Gram	600	1675	55	33
2	MAKARONA	"	40	143	80	3.2
3	ORIZ	"	40	145	70	2.8
4	SHEQER	"	80	314	60	4.8
5	FASULE	"	40	124	150	6
6	PERIME	"	200	41	70	14
7	FRUTA	"	100	42	100	10
8	VAJ	"	40	360	170	6.8
9	GJALP	"	20	152	500	10
10	MISH	"	100	144	550	55
11	DJATH	"	40	64	350	14
12	REÇEL	"	44	92	250	11
13	PATATE	"	300	255	50	15
14	QUMËSHT	"	300	147	20	6
15	VEZË	kokërr	1	93	10	10
16	Nënprodukte mishi	Gram	50	167	300	15
	KUOTA DITORE			3958		216.6

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES

(Viti mësimor 2007-2008)

PASQYRA NR 6

Nr	EMËRTIMI	Kuota financiare e Veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7.000 (shtatë mijë) lekë
2	Për jetimët	10.000 (dhjetë mijë) lekë

VENDIM
Nr.659, datë 3.10.2007

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, ME MJETE ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22 e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen autoritetet kontraktore, të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, për zbatimin e rregullave të miratuara në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK, ME MJETE ELEKTRONIKE

I. Dispozita të përgjithshme

1. Fusha e zbatimit

a) Në zbatim të nenit 22 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, përcaktohen:

i) kërkesat e nevojshme, funksionale dhe ligjore, nga autoritetet kontraktore, të përmendura në nenin 36 të ligjit, për kryerjen e procedurave të prokurimit, me mjete elektronike;

ii) kërkesat thelbësore teknike, funksionale dhe të sigurisë, që duhet të plotësojë sistemi apo mjetet elektronike, që do të përdoren për kryerjen e prokurimit.

b) Këto rregulla nuk zbatohen për veprime të tjera administrative, jashtë sferës së prokurimit publik, në procesin e ankimit administrativ, apo kurdoherë, që sipas ligjit dhe këtyre rregullave, kërkohet përdorimi i dokumenteve shkresore.

2. Me termat e mëposhtme do të kuptohet:

a) “Ligji për prokurimin publik”, ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, i cili këtë e tutje do të përdoret LPP.

b) “Rregullat e prokurimit publik”, rregullat e miratuara me vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që këtë e tutje do të përmenden me RPP.

c) “Mjete elektronike”, pajisjet elektronike, që do të përdoren për përpunimin dhe ruajtjen (përfshirë edhe përpunimin dixhital) e të dhënave, që transmetohen, jepen dhe merren përmes kabllave, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik.

ç) “Sistem elektronik prokurimi”, sistemi i integruar i pajisjeve elektronike, i përdorur për përpunimin dhe ruajtjen (përfshirë edhe përpunimin dixhital) të të dhënave, që transmetohen në rrugë elektronike, për kryerjen e procedurave të prokurimit.

d) “Nënshkrimi elektronik”, të dhënat e mbledhura në formë elektronike, që gjenden ose kanë lidhje logjike me të dhëna të tjera, po në formë elektronike, e që synojnë përcaktimin e origjinalitetit të tyre, si dhe konfirmimin e identitetit të nënshkruesit.

dh) “Nënshkrues”, personi, i cili në emër të tij apo të një personi, fizik a juridik, nënshkruan elektronikisht.

e) “Certifikatë elektronike”, vërtetimi elektronik që lidh të dhënat e nënshkrimit elektronik dhe

personit përkatës, duke konfirmuar identitetin e këtij personi.

e) “Krijimi i nënshkrimit”, *software-i ose hardware-i*, i konfiguruar, që përdoret për nënshkrimin elektronik.

f) “Autoriteti lëshues”, personi juridik, që lëshon certifikatat elektronike ose siguron shërbime të tjera, që kanë lidhje me certifikatat a me nënshkrimet elektronike.

g) “Stampimi i kohës”, koha dhe data e përcaktuar në certifikatën e nënshkruar në formë elektronike, nga autoriteti certifikues, që e lëshon atë, për përmbajtje të veçantë të të dhënave.

gj) “Dërgues”, dërguesi i mesazheve elektronike që do të thotë personi/operatori ekonomik që bën dërgesën ose personi, në emër të të cilit është dërguar mesazhi elektronik.

h) “Adresa”, adresa e mesazhit elektronik, që nënkupton vendndodhjen apo personin, të cilit i dërgohet mesazhi.

i) “Ndërveprimi”, aftësia e sistemeve të teknologjisë së shkëmbimit të informacionit dhe proceseve të mbështetura prej tyre, për të shkëmbyer informacion ose shërbime, në mënyrë të drejtpërdrejtë e të menjëhershme, dhe/ose për të funksionuar së bashku në mënyrë efikase.

3. Përdorimi i sistemit elektronik

a) Autoritetet kontraktore mund të përdorin sistemin elektronik, të ngritur sipas këtyre rregullave, për të kryer të gjitha procedurat e prokurimit, të parashikuara në LPP. Këtu përfshihen si kryerja e procedurës vetëm përmes rrugëve elektronike edhe ajo e ndërthurjes së formës elektronike me atë shkresore, për disa lloje procedurash, që e kërkojnë këtë.

b) Sistemi mund të përdoret edhe për të krijuar njoftimet e kontratës dhe të dokumenteve të tenderit për procedurat, që do të zhvillohen në formë shkresore. Në këtë rast, kërkesat e parashikuara në shkronjat “e” e “ë” të pikës 3 të kreut I të RPP-së nuk janë të zbatueshme.

c) Çdo dokument, që shoqëron ofertën ekonomike, përfshirë edhe ato që lidhen me nenet 45 e 46 të LPP-së, konvertohet në formë elektronike dhe dërgohet po në rrugë elektronike, nëse është e mundur teknikisht, duke përmbushur kështu kërkesat për dokumentacionin shoqërues të ofertës, pa qenë nevoja për t’i dërguar ato në formë shkresore. Në sistemin elektronik dhe në dokumentet e tenderit duhet të jepen të gjitha udhëzimet e nevojshme për mënyrën dhe format e konvertimit të dokumenteve.

4. Kërkesat për mjetet e komunikimit

a) Mjetet për të komunikuar përmes rrugëve elektronike dhe karakteristikat e tyre teknike nuk duhet të jenë diskriminuese, si dhe të gjenden lehtësisht e të ndërveprojnë me produktet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, që janë në përdorim të gjerë (neni 36 i LPP-së).

b) Mjetet e komunikimit duhet të jenë të ndërveprueshme, duke siguruar ndërveprimin me pajisjet dhe aplikimet e përdorura gjerësisht dhe duke mundësuar funksionet kryesore të komunikimit dhe të shkëmbimit të të dhënave, me mjetet bazë, që përdoren nga operatorët ekonomikë ose nga publiku i gjerë.

5. Integriteti dhe siguria e të dhënave

a) Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e të dhënave kryhen në mënyrë që të sigurojnë integritetin e tyre dhe konfidencialitetin e ofertave e të kërkesave për pjesëmarrje. Sistemi elektronik i shkëmbimit dhe i ruajtjes së informacionit siguron që autoritetet kontraktore të shqyrtojnë përmbajtjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor për dorëzimin e tyre, siç përcaktohet në LPP dhe në RPP.

b) Kanalet e sigurta (*https/SSL*) dhe/ose enkriptimi mund të përdoren për të ruajtur integritetin dhe konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje. Në çdo rast, në përputhje me parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit, disponueshmërisë dhe transparencës, të gjitha palëve të interesuara u vihet në dispozicion një informacion për enkriptimin, me të gjithë informacionin e nevojshëm, të specifikuar, për dorëzimin elektronik të ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

6. Dokumentimi i të dhënave

a) Sistemi elektronik i mundëson autoritetit kontraktor të dokumentojë ecurinë në procedurat e prokurimit, të kryera me rrugë elektronike. Kjo kërkesë i referohet çdo faze të procesit të prokurimit, përfshirë edhe fazën kur vihen në dispozicion dokumentet e tenderit.

b) Në mënyrë që të ruhet versioni origjinal i të gjitha dokumenteve të shkëmbyera dhe për një regjistrim të saktë të tyre, sistemi duhet të sigurojë funksione të përshtatshme, për çdo provë, që mund të nevojitet, në rast të ndonjë pretendimi.

c) Për të siguruar ofertat/kërkesat deri në orën dhe datën e përfundimit të afatit kohor për

dorëzimin e tyre dhe për të ruajtur të dhënat, nga persona të paautorizuar, merr rëndësi funksioni i gjurmueshmërisë së veprimeve, përfshirë edhe orën e datën e saktë të marrjes në dorëzim të të dhënave.

c) Funksioni i gjurmueshmërisë duhet të mundësojë verifikimin e mesazheve/të dhënave, që janë transmetuar ose janë vënë në dispozicion, emri, kujt i drejtohen, datën, përfshirë edhe kohëzgjatjen e komunikimit. Gjithashtu, duhet të mundësohet ripërcaktimi i radhës së ngjarjeve të ndodhura, përfshirë të gjitha të dhënat e përpunuara elektronikisht ose përlogaritjet automatike, si dhe nëse ka pasur ndërhyrje apo është kompromentuar, në ndonjë mënyrë, sistemi ku kryhet procesi i prokurimit.

II. Njoftimet dhe aksesit elektronik i dokumenteve të tenderit

7. Përgatitja dhe dorëzimi elektronik i njoftimeve

a) Autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve elektronike të tenderit. Në përgatitjen e tyre mbahen parasysh kërkesat e përcaktuara në RPP, për atë sa ato janë të zbatueshme, dhe ku, detyrimisht, përfshihet nxjerrja e urdhrat të prokurimit dhe emërimi i anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave. Njësia e prokurimit përgjigjet për hedhjen e të dhënave në sistem, pasi të ketë krijuar *loget* përkatëse.

b) Njoftimet e kontratave, në zbatim të nenit 38 të LPP-së, i dërgohen nëpërmjet sistemit elektronik, Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila duhet t'i botojë në faqen elektronike brenda afateve. Njoftimet elektronike të kontratave duhet të përmbajnë, së paku, të gjithë informacionin, që parashikohet në shkronjën "a" të seksionit 2 të kreut III të RPP-së. Botimi i njoftimit elektronik të kontratës shmanget detyrimin e botimit të të dhënave në formë të shkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

c) Autoritetet kontraktore, të cilat kanë faqe interneti, krijojnë një seksion, të quajtur "Profili i blerësit", ku botojnë njoftime paraprake, informacione dhe njoftime të tjera, që publikohen edhe nga APP-ja. Profili i blerësit mund të përfshijë edhe informacione për njoftimet e kontratës apo ftesat për ofertë, që janë ende në vazhdim, për prokurimet e parashikuara, kontratat e përfunduara, procedurat e anuluar, si dhe çdo informacion tjetër të dobishëm, të tilla si mënyra e kontaktimit me autoritetin kontraktor etj.

8. Aksesit elektronik në dokumentet e tenderit

Aksesit elektronik në dokumentet e tenderit mund të sigurohet në mënyrat e përcaktuara në njoftim. Për të siguruar akses, të plotë e të pakufizuar, në dokumentet e tenderit duhet që të gjitha dokumentet përkatëse të jenë në dispozicion, në faqen e internetit, në çdo çast, duke filluar nga dita e botimit të njoftimit deri në përfundimin e afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Sistemi bën të mundur dërgimin, me rrugë elektronike, të dokumenteve të tenderit për çdo njoftim të ri kontrate, në rast se operatorët ekonomikë janë të regjistruar në sistem.

III. Kryerja e procedurave përmes sistemit elektronik

9. Dorëzimi në formë elektronike

a) Në procesin e prokurimit publik, me mjete elektronike, sistemi i komunikimit mund të përdoret për të marrë oferta, kërkesa për pjesëmarrje dhe çdo dokument, që lidhet me procesin. Rrjedhimisht, të gjitha kërkesat e përmendura më sipër për përkufizimin dhe përdorimin e mjeteve e të pajisjeve elektronike janë njëlloj të zbatueshme, së bashku me kërkesat e veçanta, që shpjegohen në vijim.

b) Autoriteti kontraktor është i lirë të zgjedhë mjetet e përshtatshme të komunikimit dhe është përgjegjës për organizimin e marrjes së ofertave apo të kërkesave për pjesëmarrje, në mënyrë elektronike, në përputhje me kërkesat ligjore, të parashikuara në këto rregulla. Operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë specifikimet e pajisjes marrëse, për të paraqitur një ofertë të vlefshme.

10. Aksesit në pajisje

Për të garantuar kërkesat për akses, të parashikuara në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 36 të LPP-së, kërkesa e parë është sigurimi i specifikimeve të nevojshme, përfshirë enkriptimin për palët e interesuara. Këto specifikime duhet të përshkruhen në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, duke përfshirë edhe llojet e format, që do të përdoren. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit elektronik, mund të kërkojë një format të veçantë apo që ofertat të strukturohen në një mënyrë të caktuar.

11. Nënshkrimi elektronik dhe siguria e të dhënave

a) Autoriteti lëshues duhet të sigurojë se sistemi për nënshkrimin elektronik plotëson kërkesat

e mëposhtme:

i) të dhënat, që përdoren për gjenerimin e nënshkrimit, mund të vihen në përdorim vetëm një herë dhe se fshehtësia e tyre ruhet në mënyrë të kënaqshme;

ii) të dhënat e nënshkrimit nuk tjetërsohen, nëse tregohet kujdes i zakonshëm, dhe se nënshkrimi është i mbrojtur ndaj përvetësimit të paligjshëm;

iii) të dhënat e përdorura për gjenerimin e nënshkrimit mbrohen nga nënshkruesi i ligjshëm, nga përdorimi prej personave të tjerë.

b) Sistemi elektronik, i përdorur për marrjen e ofertave, garanton se nënshkrimi elektronik është në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 36 të LPP-së.

c) Pavarësisht nga sa më lart dhe derisa të miratohet legjislacioni për nënshkrimin elektronik, zgjidhja e përkohshme do të jetë regjistrimi ose pranimi i nënshkrimit të thjeshtë elektronik, i cili përbëhet nga një emër përdorimi dhe fjalëkalimi unik. Operatori ekonomik i interesuar, kur regjistrohet për herë të parë në sistem, fut të gjitha të dhënat, që i kërkohen, në rrugë elektronike. Të dhënat përpunohen automatikisht nga sistemi, i cili, nëse është e nevojshme, kërkon dërgimin e ndonjë të dhëne të veçantë, në formë shkresore, në autoritetin lëshues, për certifikimin e identitetit të dërguesit të këtyre të dhënave.

ç) Brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 10 ditë, autoriteti lëshues dërgon, në formë shkresore dhe elektronike, emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për operatorin ekonomik. Këto të dhëna aktivizohen brenda një afati të caktuar dhe mund të ndryshohen në çdo kohë, nga operatori ekonomik. Çdo operator ekonomik, sa herë që do të dorëzojë një ofertë, përdor emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi përbëjnë lidhjen logjike, ndërmjet dërguesit të materialit dhe përmbajtjes së këtij materiali, në përputhje me kërkesat e nenit 36 të LPP-së, për përshtatshmërinë e nënshkrimit elektronik.

12. Stampimi i kohës

a) Sistemi garanton stampimin e kohës së saktë të marrjes së dokumentit. Kjo do të thotë se të dhënat u stampohen ora dhe data, të cilat ruhen automatikisht.

Stampimi i kohës kryhet në fillim dhe në fund të çdo dokumenti të marrë.

b) Sistemi duhet të përcaktojë kohën, kur do të trajtohen veprimet e caktuara. Kur mungon ndonjë tregues i veçantë, atëherë transmetimi në fjalë kryhet para skadimit të afatit kohor.

c) Sistemi lëshon, automatikisht, njoftimin për marrjen me sukses të ofertës, e cila dërgohet në adresën elektronike të ofertuesit. Gjithashtu, sistemi mundëson informacionin e mjaftueshëm për ofertuesin, nëse dërgimi elektronik i ofertës së tij ose dorëzimi i saj nuk ka qenë i suksesshëm, veçanërisht në rastet kur zbulohet virus. Në këtë rast vlerësohet se oferta nuk është dorëzuar dhe mundësohet ridorëzimi i saj, me kusht që të mos ketë mbaruar afati kohor i përcaktuar.

13. Aksesimi i të dhënave (oferta/kërkesat) e transmetuara

a) Sistemi në përputhje me pikën 4 të nenit 22 të LPP-së, duhet të garantojë ruajtjen (mbrojtjen) e të dhënave të transmetuara përfshirë edhe zbulimin e ndonjë ndërhyrjeje të paautorizuar. Kjo nënkupton se të dhënat e transmetuara merren dhe ruhen automatikisht, pa lejuar që dikush të ketë mundësi të njihet me to, derisa të ketë përfunduar afati kohor për hapjen e tyre. Gjithashtu, sistemi duhet të garantojë se, teknikisht, dokumentohet çdo ndërhyrje në server. Hyrja në sistem dhe të gjitha veprimet e kryera me të dhënat regjistrohen dhe ruhen, për të siguruar gjurmueshmërinë e veprimeve. Para se të hapen të dhënat, sistemi konfirmon se nuk është zbuluar asnjë ndërhyrje e paautorizuar.

b) Sistemi garanton se vetëm personat e autorizuar kanë mundësinë të vendosin ose të ndryshojnë afatet për hapjen e ofertave a të kërkesave për pjesëmarrje, të marra. Siç parashikohet në disa lloje procedurash prokurimi publik, mund të lindë nevoja që të shtyhet hapja e disa pjesëve të caktuara të ofertës. Në këtë rast, sistemi duhet ta mundësojë këtë veprim, pa kompromentuar sigurinë për pjesët e pahapura dhe në përgjithësi, si dhe garanton se ndryshimi i datës nuk sjell pasoja të dëmshme për konfidencialitetin e ofertave.

c) Sistemi garanton që aksesimi në ofertat apo kërkesat e dorëzuara bëhet i mundur vetëm përmes veprimeve të njëkohshme nga personat e autorizuar, dhe vetëm pasi të ketë skaduar afati i përcaktuar. Rrjedhimisht, pas marrjes në dorëzim të dhënave mbeten të aksesueshme vetëm për anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, që duhet të njihen me to.

ç) Anëtarët e komisionit të vlerësimit kanë një çelës individual, kodet e të cilit aktivizohen vetëm pas skadimit të afatit kohor, të përcaktuar për dorëzimin e ofertave. Në datën dhe orën e përcaktuar për hapjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, anëtarët e komisionit, në mënyrë

publike, procedojnë me çkodimin e të dhënave, për të siguruar akses, të llojit vetëm “lexim”. Më pas verifikohen certifikimet elektronike dhe konfirmohet integriteti i të dhënave, si dhe kontrollohet nëse dorëzimi i tyre është kryer brenda afatit kohor. Përsa kohë që dokumentet mbahen në sistem, ato mund të kontrollohen sipas skedarit bazë (*master files*).

d) Informacioni i dhënë në nenin 52 të LPP-së dhe informacioni, që kërkohet të bëhet publik gjatë hapjes publike, mund të vihen në dispozicion, në formë elektronike dhe në kohë reale, për të gjithë ofertuesit, nëse sistemi e mundëson një gjë të tillë. Autoriteti kontraktor duhet të lejojë praninë e ofertuesit të interesuar gjatë fazës së hapjes së ofertës, nëse kërkohet nga ky i fundit, duke përcaktuar në njoftim vendin dhe orën, ku do të kryhet hapja e tyre.

dh) Pas vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor verifikon të gjithë informacionin e paraqitur vetëm për ofertuesit, që përcaktohen në shkronjën “gj” të pikës 4 të kreut V të RPP-së, dhe kur vëren pasaktësi apo të dhëna të rreme, zbaton procedurat e parashikuara në nenin 47 të LPP-së.

e) Në mbyllje të procesit, vetë sistemi gjeneron një raport përmbledhës, me të gjitha fazat e procedurës, ku përfshihet, së paku, informacioni i përcaktuar në nenin 12 të LPP-së.

Informacioni i plotë për të gjithë procedurën ruhet nga vetë sistemi, duke krijuar mundësi auditimi, në çdo kohë. Një kopje e këtij raporti mund të printohet dhe ruhet sipas kërkesave të LPP-së dhe legjislacionit në fuqi, për administrimin dhe ruajtjen e dokumenteve zyrtare. Procedurat e prokurimit, të përfunduara, ruhen në sistem dhe janë plotësisht të lejueshme për publikun e gjerë, me përjashtim të informacionit të rezervuar, që cilësohet i tillë në pikën 3 të nenit 21 të LPP-së.

14. Kopja dhe ruajtja e të dhënave

a) Paralel me sistemin elektronik për prokurimin ngrihet dhe funksionon një sistem për kopjimin dhe ruajtjen e të dhënave (*back up*), i cili përfshin një numër masash, për administrimin e këtij procesi.

b) Sistemi *back up* i të dhënave të ruhet në një vend tjetër, jashtë mjediseve, ku është instaluar sistemi elektronik. Sistemi i kopjimit dhe i ruajtjes të së dhënave mbrohet fizikisht dhe i enkriptuar, për të shmangur çdo ndërhyrje.

c) Kopjimi dhe ruajtja e të dhënave bëhen në fillim të çdo ditë pune, në fund të javës dhe në ditën e fundit të punës së muajit dhe kryhen menjëherë pas hapjes publike të ofertave apo kërkesave.

ç) Paralel me sistemin e *back up*, pranë Këshillit të Ministrave instalohet edhe një server i tretë, i cili regjistron të gjitha proceset dhe ndërhyrjet në sistemin e prokurimit elektronik. Në të lejohej të ndërhyhet vetëm në rast të ndonjë pretendimi apo për qëllime auditimi, me udhëzim të veçantë dhe me pjesëmarrjen e më shumë se të një zyrtari, siç përcaktohet në pikën 19.

IV. Dispozita të fundit

15. APP-ja, në zbatim të pikës 11 të këtyre rregullave, do të jetë derisa ligjet për nënshkrimin elektronik dhe qeverisjen elektronike të përcaktojnë një autoritet tjetër, autoriteti lëshues përgjegjës, për të përbushur këtë funksion, vetëm për procesin e prokurimit, me mjetet elektronike.

16. APP-ja, për të mbështetur autoritetet kontraktore, krijon dhe mirëmban një sistem dhe faqe të veçantë për prokurimin elektronik, në përputhje me këto rregulla dhe me praktikat më të mira të Bashkimit Europian, të cilat do të shërbejnë edhe për njoftimet elektronike të kontratave, të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 7.

17. Që autoritetet kontraktore të interesuara të mund t’i zhvillojnë prokurimet përmes sistemit elektronik, duhet, paraprakisht, të regjistrohen në këtë sistem.

Çdo autoritet kontraktor i regjistruar duhet të përcaktojë emrat e zyrtarëve përgjegjës, që do të marrin pjesë në procedurat e prokurimit, në mënyrë që APP-ja t’i pajisë me fjalëkalimet përkatëse.

18. Agjencia e Prokurimit Publik miraton rregullat, udhëzimet dhe manualët e përdorimit, të nevojshme, për të vënë në zbatim këto rregulla, si dhe ofron mbështetjen e nevojshme për autoritetet kontraktore apo operatorët ekonomikë të interesuar.

19. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për funksionimin dhe administrimin e sistemit dhe të ruajtjes së të dhënave. Në udhëzim të përcaktohen kushtet, procedurat për sigurinë dhe mbrojtjen e sistemit, si dhe të sanksionohet se ndërhyrja në sistem bëhet vetëm me *logimin* e njëkohshëm të disa personave, që e kanë këtë akses.

Këtë akses e kanë Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik, Drejtori i Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit, si dhe një përfaqësues i zyrës së Avokatit të Prokurimeve Publike.

VENDIM
Nr.660, datë 12.9.2007

**PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËSVE DHE
KANALIZIMEVE NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 1.II, shkronja “a”, 10, pika 3.I, shkronjat “a” e “b”, dhe 72, pika 5.I, shkronjat “a” e “b” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të neneve 3, shkronja “e”, 4, 6, shkronja “a”, 7, 8 e 16, pika 1 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e aksioneve të shoqërive shtetërore të ujësjellësve dhe kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kur shoqëria e ujësjellësve dhe kanalizimeve mbulon më shumë se një njësi qeverisjeje vendore, bazuar në shitjen me pakicë, në marrëdhëniet tregtare me përdoruesit finalë, aksionet e shoqërisë, që transferohen, u kalojnë njësive të qeverisjes vendore përkatëse në bashkëpronësi, ku pjesa takuese e aksioneve të çdo njësie është në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë së asaj njësie, që mbulohet nga shoqëria e ujësjellësit dhe kanalizimeve.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve sipas këtij vendimi, janë të detyruara, që, për një periudhë kohore prej jo më pak se dy (2) vjetësh nga data e bërjes efektive të transferimit të aksioneve.

a) të mos shesin aksionet e tyre te persona, fizikë ose juridikë, të tjerë, shtetërorë a privatë;

b) të mos kryejnë ndarje të shoqërisë, por ta mbajnë atë si një njësi ligjore të vetme operuese.

4. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përfitojnë prona sipas këtij vendimi, të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me ligjin nr.8744, datë 22.2.2001, të cilin e paraqet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

5. Detyrimet e prapambetura të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, deri në çastin e transferimit, sipas përcaktimeve të bëra në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të shlyhen nga Buxheti i Shtetit dhe bilancet e shoqërive, aksionet e të cilave transferohen, të zhvishen nga detyrimet e prapambetura përpara se të kryhet transferimi i aksioneve të tyre në njësitë e qeverisjes vendore.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme të dokumenteve ligjore dhe të udhëzuesve bazë, të nevojshëm (statuti i shoqërisë së transferuar dhe vendimit nr.642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave “Për këshillat mbikëqyrëse të shoqërive anonime shtetërore”), të cilët do të bëjnë të mundur rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpronësisë, ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, si bashkëpronarë dhe të marrëdhënieve, ndërmjet këtyre të fundit me shoqëritë, që menaxhojnë sistemet e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të transferuara.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të programojë dhe të ndjekë zbatimin e udhëzimeve dhe të akteve nënligjore, për ngritjen e asambleve të ortakëve të njësive të qeverisjes vendore, bashkëpronarë të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, të transferuara sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Pika 3, e lidhjes 2, dhe pikat 1,3,4, sistemet 12 e 13, 5,6 e 7 të lidhjes 3 të vendimit nr.81, datë 12.2.2004 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”, pika 2 e lidhjes 3 të vendimit nr.173, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”, pikat 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9,10,11 e 12 të lidhjes 2 dhe pikat 1, 2, 3, 4, 5, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 e 21 të lidhjes 3 të vendimit nr.809, datë 26.11.2004 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e

pronave të paluajjtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”, si dhe vendimi nr.711, datë 18.10.2006, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e pronave të paluajjtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore”, shfuqizohen.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA 1

Lista e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, aksionet e të cilave do të transferohen në njësitë e qeverisjes vendore (Nj.Q.V)

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njesisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
1	Ujësjellës Kraste	Sh.a		366,05.06.2003	2.735	Komunës Martanesh	2.735	100,0
2	Ujësjellës Selenice	Sh.a			7.012	Bashkisë Selenice	7.012	100,0
3	Ujësjellës Rubik	Sh.a	7	643,18.09.2003	8.059	Bashkisë Rubik	8.059	100,0
4	Ujësjellës Bilisht	Sh.a	7	366,05.06.2003	9.704	Bashkisë Bilisht	9.704	100,0
5	Ujësjellës Oriukum	Sh.a			11.036	Bashkisë Oriukum	11.036	100,0
6	Ujësjellës Poliçan	Sh.a	10	251,24.04.2003	12.164	Bashkisë Poliçan	9.530	78,3
						Komunës Bogovë	2.534	20,8
7	Ujësjellës Përmet	Sh.a	9	251,24.04.2003	13.830	Komunës Vendreshë	100	0,8
						Bashkisë Përmet	10.742	77,7
8	Ujësjellës Has	Sh.a	20	366,05.06.2003	13.453	Komunës Petran	3.088	22,3
						Bashkisë Krumë	7.705	57,3
9	Ujësjellës Kanalizime Peqin	Sh.a			14.138	Komunës Fajza	4.201	31,2
						Komunës Gjinaj	1.547	11,5
						Bashkisë Peqin	8.919	63,1
						Komunës Shezë	5.219	36,9

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
10	Ujësjellës kanalizime Mirditë	Sh.a			17.953	Bashkisë Rrëshen	14.253	79,4
11	Ujësjellës Bulqizë	Sh.a	1	251,24.04.2003	18.305	Komunës Selitë(pjesërisht)	2.500	13,9
						Komunës Orosh(pjesërisht)	1.200	6,7
12	Ujësjellës Kanalizime Librazhd	Sh.a	5	643,18.09.2003	19.187	Bashkisë Bulqizë	13.913	76,0
						Komunës Shupenzë(pjs)	4.392	24,0
13	Ujësjellës Kanalizime Krujë	Sh.a	7	643,18.09.2003	19.514	Bashkisë Librazhd	10.123	52,8
						Bashkisë Prrerjas	8.264	43,1
						Komunës Qender	600	3,1
						Komunës Rajcë(pjeseri)	200	1,0
						Bashkisë Krujë	15.789	80,9
						Komunës Cudhi	3.725	19,1
						Bashkisë Çorovodë	8.422	35,7
						Komunës Qendër	6.097	25,8
14	Ujësjellësi Skrapar	Sh.a	13	251,24.04.2003	23.599	Komunës Potom	1.310	5,6
						Komunës Çepan	1.515	6,4
						Komunës Gjerbës	1.817	7,7
						Komunës Vendreshë	100	0,4
						Komunës Bogovë	2.534	10,7
						Komunës Zhepë	1.804	7,6
15	Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë	Sh.a	12	251,24.04.2003	21.241	Bashkisë Rrogozhinë	11.123	52,4
						Komunës Gosë	8.124	38,2
						Komunës Sinaballaj	1.994	9,4

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
16	Ujësjetllës Ura Vajgurore	Sh.a	6	366,05.06.2003	21.985	Bashkisë Ura Vajgurore	12.011	54,6
						Komunës Poshnjë	9.974	45,4
17	Ujësjetllës Mat	Sh.a	1	643,18.09.2003	23.259	Bashkisë Burrel	18.195	78,2
						Komunës Lis	5.064	21,8
						Komunës Rrapë	2.652	11,3
						Komunës Qafë Mali	2.067	8,8
						Komunës Gjegan	4.855	20,7
18	Ujësjetllës Kanalizime Pukë	Sh.a	11	251,24.04.2003	23.430	Komunës Blerim	2.432	10,4
						Komunës Qelëz	2.639	11,3
						Komunës Fierzë	2.556	10,9
						Komunës Qerret	3.509	15,0
						Komunës Iballë	2.720	11,6
						Bashkisë Bajram Curri	8.460	30,0
						Komunës Margegaj	3.081	10,9
						Komunës Tropojë	5.669	20,1
19	Ujësjetllësi Tropoje	Sh.a	2	366,05.06.2003	28.168	Komunës Bujan	3.608	12,8
						Komunës Llugaj	2.371	8,4
						Komunës Fierze	2.917	10,4
						Komunës Bytyç	2.062	7,3

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
20	Ujësjetllës Gramsh	Sh.a	3	251,24.04.2003	30.576	Bashkisë Gramsh	14.542	47,6
						Komunës Kushovë	1.230	4,0
						Komunës Pishaj	7.873	25,7
						Komunës Tunjë	2.228	7,3
						Komunës Sult	1.455	4,8
						Komunës Kodovjat	3.248	10,6
21	Ujësjetllësi Kukës	Sh.a	9	366,05.06.2003	31.770	Bashkisë Kukës	21.308	67,1
						Komunës Shtiqën	4.033	12,7
						Komunës Bieaj	6.429	20,2
						Bashkia Tepelenë	8.208	24,1
						Bashkia Memaliaj	7.399	21,7
22	Ujësjetllësi Tepelenë	Sh.a	14	643,18.09.2003	34.050	Komunës Qendër Tepelenë	6.799	20,0
						Komunës Qendër Memaliaj	3.546	10,4
						Komunës Qesarat	2.665	7,8
						Komunës Krahës	3.910	11,5
						Komunës Kurvelesh	1.523	4,5
23	Ujësjetllësi Gjirokastër Qytet	Sh.a	18	366,05.06.2003	37.241	Bashkisë Gjirokastër	35.241	94,6
						Kom. Lunxhëri (pjesërisht)	2.000	5,4
						Bashkisë Ballsh	11.698	30,7
						Komunës Qendër Dukas	8.811	23,1
24	Ujësjetllës Kanalizime Mallakastër	Sh.a	11	643,18.09.2003	38.090	Komunës Aranitas	4.474	11,7
						Komunës Hekal	4.776	12,5
						Komunës Kute	3.426	9,0
						Kumuna Fratar	4.905	12,9

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njesisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
25	Ujësjellës Kanalizime Lezhë	Sh.a	13	366.05.06.2003	47.565	Bashkisë Lezhë	26.156	55,0
						Komunës Shëngjin	10.864	22,8
						Komunës Balldre	10.545	22,2
26	Ujësjellësi Kuçovë	Sh.a	5	251.24.04.2003	49.034	Bashkia Kuçovë	30.303	61,8
						Komunës Perondi	8.098	16,5
						Komunës Kozare	10.633	21,7
						Bashkisë Peshkopi	18.445	36,8
						Komunës Kala e Dodës	3.340	6,7
						Komunës Slllovë	3.435	6,8
27	Ujësjellës Kanalizime Peshkopi	Sh.a	8	251.24.04.2003	50.184	Komunës Fushë Cidhen	4.027	8,0
						Komunës Luzni	3.736	7,4
						Komunës Kastriot	7.698	15,3
						Komunës Qendër Tomin	9.503	18,9
						Bashkisë Koplik	11.001	20,2
						Komunës Shkrel	5.998	11,0
28	Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe	Sh.a	6	251.24.04.2003	54.418	Komunës Qendër Koplik	5.881	10,8
						Komunës Kastrat	12.104	22,2
						Komunës Kelmend	6.669	12,3
						Komunës Gruemirë	12.765	23,5
29	Ujësjellës Kanalizime Pogradec	Sh.a	10	366.05.06.2003	55.755	Bashkisë Pogradec	39.646	71,1
						Komunës Buçimas	16.109	28,9
						Bashkisë Patos	32.499	54,4
30	Ujësjellës Patos	Sh.a	17	366.05.06.2003	59.714	Komunës Cakran	16.183	27,1
						Komunës Portëz	11.032	18,5

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
31	Ujësjellësi Shkodër Fshat	Sh.a	4	366.05.06.2003	68.770	Komunës Bërdicë	9.101	13,2
						Komunës Velipojë	8.403	12,2
						Komunës Hajmel	6.319	9,2
						Komunës Gur I Zi	11.591	16,9
						Komunës Ana e Malit	5.847	8,5
						Komunës Shalë	5.044	7,3
						Komunës Rrethinat	22.465	32,7
32	Ujësjellësi Kanalizime Kurban	Sh.a			64.549	Bashkisë Lac	29.891	46,3
						Bashkisë Mamurras	21.852	33,9
						Komunës Milot	12.806	19,8
33	Ujësjellës Kanalizime Sarandë	Sh.a	17	643,18.09.2003	61.942	Bashkisë Sarandë	39.192	63,3
						Komunës Dhimër	6.255	10,1
						Komunës Aliko	8.563	13,8
						Komunës Mesopotam	6.132	9,9
						Komunës Finiq(F.Vrion)	1.800	2,9
						Bashkisë Maliq	8.075	9,3
						Komunës Drenovë	10.920	12,6
						Komunës Voskop	6.150	7,1
34	Ujësjellësi Korçë Fshat	Sh.a	9	643,18.09.2003	86.681	Komunës Qendër Bulgarec	13.644	15,7
						Komunës Pojan	17.145	19,8
						Komunës Progër	6.041	7,0
						Komunës Vreshtas	10.391	12,0
						Komunës Libonik	14.315	16,5

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
35	Ujësjetillësi Berat	Sh.a	1	366,05.06.2003	84.257	Bashkisë Berat	63.724	75,6
36	Ujësjetillës Kanalizime Korce	Sh.a	19	366,05.06.2003	86.040	Komunës Vërtop	7.211	8,6
						Komunës Otlak	13.322	15,8
37	Ujësjetillës Kanalizime Kavajë	Sh.a	12	643,18.09.2003	91.848	Bashkisë Koryevidh	86.040	100,0
						Bashkisë Kavajë	38.291	41,7
						Komunës Synaj	10.087	11,0
						Komunës Golem	11.241	12,2
						Komunës Helmës	4.548	5,0
						Komunës Lekaj	9.367	10,2
						Komunës Luz I Vogël	9.740	10,6
						Komunës Kryevidh	8.574	9,3
						Komunës Tërbuf	14.830	14,4
						Komunës Kolonjë	8.145	7,9
						Komunës Libofsh/Fier	10.303	10,0
						Komunës Dushk	10.928	10,6
						Komunës FierShegan	8.843	8,6
						Komunës Allkaj	5.978	5,8
						Komunës Bubullime	6.974	6,8
						Komunës Krutje	10.029	9,7
						Komunës Poshnjë/Berat	9.974	9,7
						Komunës Gradisht	10.501	10,2
38	Ujësjetillësi Lushnjë Fshat	Sh.a	12	366,05.06.2003	102.925	Komunës Remas	6.420	6,2

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësies	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
39	Ujësjetillësi Kanalizime Shkoder	Sh.a	14	251.24.04.2003	112.783	Bashkisë Shkoder	112.783	100,0
40	Ujësjetillësi Elbasan Fshat	Sh.a	5	366.05.06.2003	141.544	Bashkisë Cërrik	14.620	10,3
						Bashkisë Belsh	13.955	9,9
						Komunës Grekan	4.901	3,5
						Komunës Gostimë	12.118	8,6
						Komunës Shalës	6.951	4,9
						Komunës Kajan	6.268	4,4
						Komunës Rrasë	2.235	1,6
						Komunës Fierzë	3.742	2,6
						Komunës Papër	8.916	6,3
						Komunës Gjergjan	7.519	5,3
						Komunës Mollas	7.376	5,2
						Komunës Bradashesh	12.539	8,9
						Komunës Gracen	2.527	1,8
						Komunës Gjinar	4.809	3,4
41	Ujësjetillës Elbasan Qytet	Sh.p.k			131.643	Komunës Zavalinë	2.104	1,5
						Komunës Labinot-Fushë	6.010	4,2
						Komunës Labinot-Mal	5.450	3,9
						Komunës Shirgjan	9.327	6,6
						Komunës Shushicë	10.177	7,2
						Bashkisë Elbasan	124.643	94,7
						Komunës Bradashesh(pjes)	7.000	5,3

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
42	Ujësjellës Vlorë	Sh.a	16	251,24.04.2003	182.296	Bashkisë Vlorë	128.744	70,6
						Bashkisë Himarë	11.613	6,4
						Komunës Shushicë	9.114	5,0
						Komunës Armen	7.772	4,3
						Komunës Kote	7.343	4,0
43	Ujësjellës Kanalizime Fier	Sh.a	13	643,18.09.2003	158.648	Komunës Qendër	17.710	9,7
						Bashkisë Fier	84.125	53,0
						Bashkisë Roskovec	8.491	5,4
						Komunës Topojë,Seman	7.375	4,6
						Komunës Dermenas	12.070	7,6
						Komunës Levan	16.709	10,5
						Komunës Frakull	10.040	6,3
						Komunës Qendër	11.801	7,4
						Komunës Kuman	8.037	5,1
						Komunës Lunxheri	5.216	12,5
44	Ujësjellës Gjirrokaster fshat	Nderm.			41.885	Komunës Qender Libohov	2.930	7,0
						Komunës Lazarat	3.364	8,0
						Komunës Cepo	4.538	10,8
						Komunës Antigone	1.807	4,3
						Komunës Odrie	1.608	3,8
						Komunës Picar	2.118	5,1
						Komunës Zagori	1.316	3,1
						Komunës Dropull i Siperm	9.590	22,9
						Komunës Dropull i Poshte	9.398	22,4

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
45	Ujësjellësi Kanalizime Tiranë	Sh.a	15	366,05.06.2003 643,18.09.2003	836.064	Bashkisë Tiranë	606.437	72,5
						Bashkisë Kamëz	85.123	10,2
						Bashkisë Vorë	11.500	1,4
						Komunës Bërzhitë	5.639	0,7
						Komunës Shëngjergj	3.475	0,4
						Komunës Prezë	3.500	0,4
						Komunës Petrelë	6.389	0,8
						Komunës Dajt	10.589	1,3
						Komunës Baldushk	5.424	0,6
						Komunës Paskuqan	36.710	4,4
						Komunës Zall Herr	9.895	1,2
						Komunës Kashar	19.412	2,3
						Komunës Farkë	10.797	1,3
						Komunës Krrabë	3.053	0,4
						Komunës Bërksullë	9.094	1,1
						Komunës Vaqarr	9.027	1,1
46	Ujësjellës Kanalizime Delvinë	Sh.a	3	366,05.06.2003	15.444	Bashkisë Delvinë	13.944	90,3
						K.Mesopotam(F.Bistrice)	1.500	9,7

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarëve		Nr. Popullsisë	Njësitë e Qeverisjes Vendore		
			Lista nr. __	VKM Nr. __, Datë __		Emri i Njësisë	Nr. Popullsisë	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
47	Ujësjellësi Kanalizime Durrës	Sh.a	10	643,18.09.2003	358.498	Bashkisë Durrës	196.075	54,7
						Bashkisë Shijak	12.799	3,6
						Bashkisë Vore	7.000	2,0
						Bashkisë Sukth	24.304	6,8
						Bashkisë Manëz	9.031	2,5
						Komunës Thumanë	16.703	4,7
						Komunës Ishëm	3.580	1,0
						Komunës Xhafzotaj	16.123	4,5
						Komunës Rrashbull	25.841	7,2
						Komunës Katund i Ri	15.397	4,3
						Komunës Bubq	7.882	2,2
						Komunës Prezë	2.849	0,8
						Komunës Fush-Kuqe	8.440	2,4
						Komunës Maminas	6.633	1,9
						Komunës Gjepalaj	5.841	1,6

LIDHJA 2

**Detyrimet financiare të prapambetura të shoqërive të ujësjellësave
dhe kanalizimeve deri më 31.08.2007.**

nr		Emertimi i ndermarrjes	Sig. 000/leke	Tatimet 000/leke	ARMO 000/ leke	Energj 000/leke	Alpetrol sh.a	Totali i detyrimit
1		sh.a ujesj. kanaliz. Kraste	552.00	31.00	-	171.00		754.00
2		" " Selenice		-	-	2,797.00		2,797.00
3		" " Rubik	-	-	-	-		-
4		" " Bilisht	-	3,982.00	-	1,432.00		5,414.00
5		" " Orikum				1,167.00		1,167.00
6		" " Polican	9,530.00	5,563.00	-	1,668.00		16,761.00
7		" " Permet	1,413.00	-	-	1,824.00		3,237.00
8		" " Has	4,293.00	2,521.00	-	1,683.00		8,497.00
9		" " Peqin	1,274.00	-	-	1,381.00		2,655.00
10		" " Mirdite	3,614.00	2,075.00	-	1,964.00		7,653.00
11		" " Bulqize	7,916.00	4,329.00	-	853.00		13,098.00
12		" " Librazhd	-	-	-	129.00		129.00
13		" " Kruje	1,965.00	9,882.00	-	52.00		11,899.00
14		" " Skrapar	-	-	-	1,877.00		1,877.00
15		" " Rogozhine	-	-	-	1,345.00		1,345.00
16		" " Ura vajgurore	-	-	-	1,856.00		1,856.00
17		" " Mat	9,093.00	13,328.00	-	-		22,421.00
18		" " Puke	4,543.00	103.00	-	44.00		4,690.00
19		" " Tropoje	1,499.00	-	-	3,917.00		5,416.00
20		" " Gramsh	1,575.00	-	-	156.00		1,731.00
21		" " Kukes	1,394.00	30,267.00	-	-		31,661.00
22		" " Tepelene	-	-	-	4,505.00		4,505.00
23		sh.a ujesj. kanaliz. Gjirokastrer qytet	9,559.00	-	-	1,500.00		11,059.00
24		" " Mallakaster	5,323.00	335.00	122,649.00	1,413.00		129,720.00
25		" " Lezhe	-	-	-	12,118.00		12,118.00
26		" " Kucove	74,560.00	1,729.00	-	5,558.00		81,847.00
27		" " Peshkopi	-	-	-	1,792.00		1,792.00
28		" " Malesi e Madhe	7,500.00	-	-	-		7,500.00

29	"	Pogradec	-	-	-	-	-	-	-
30	"	Patos	24,000.00	-	-	4,000.00	22,796.00	288,000.00	338,796.00
31	"	Shkoder fshat	5,326.00	-	-	-	2,945.00	-	8,271.00
32	"	Kurbin	6,558.00	12,006.00	-	-	15,457.00	-	34,021.00
33	"	Sarande	-	-	-	-	8,802.00	-	8,802.00
34	"	Korce fshat	7,899.00	4,885.00	-	-	2,237.00	-	15,021.00
35	"	Berat	27,899.00	53,216.00	-	-	1,010.00	-	82,125.00
36	"	Korce qytet	-	-	-	-	-	-	-
37	"	Kavaje	-	-	-	-	6,450.00	-	6,450.00
38	"	Lushnje fshat	18,595.00	-	-	-	4,361.00	-	22,956.00
39	"	Shkoder qytet	68,217.00	88,324.00	-	-	29,840.00	-	186,381.00
40	"	Elbasan fshat	8,285.00	-	-	-	22,672.00	-	30,957.00
41	shpk ujes.kanaliz.	Elbasan qytet	27,935.00	-	-	-	-	-	27,935.00
42	sha ujesjelles	Vlore	-	-	-	-	31,349.00	-	31,349.00
43	sh.a ujesj. Kanaliz.	Fier	3,049.00	-	-	-	32,756.00	-	35,805.00
44	Nd. ujesjellesit	Gjirokastr fshat	3,096.00	-	-	-	1,202.00	-	4,298.00
45	sh.a ujesj. kanalizime	Tirane	68,442.00	-	-	-	-	-	68,442.00
46	"	Delvine	-	-	-	-	3,098.00	-	3,098.00
47	"	Durres	-	-	-	-	109,408.00	-	109,408.00
		Shuma	414,904.00	232,576.00	126,649.00	345,585.00	288,000.00	1,407,714.00	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësura gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 22.10.2007
Doli nga shtypi më 24.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 32 lekë